



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A.nr. 344/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Muhamet Rexha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovë (AAK), në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 10.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar.

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3600 (tremijegjashtëqind) euro, te cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **A R S Y E T I M**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 06.12.2010, ku Lëvizja Vetëvendosja ka parashtruar ankesë më te cilën pretendon se subjekti politik AAK, se me date 5 dhjetor 2010 në ora 21:00 në rrugën Dëshmorë e Kombit në Ferizaj anëtarët e subjektit politik AAK kanë vendosur posterin e kandidatit për deputet Rexhep Gjergji mbi posterat e Lëvizjes Vetëvendosje, fakt që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Rexhep Gjergji, nga radhët e subjektit politik AAK, është vendosur mbi posterat e Lëvizjes Vetëvendosje. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

**Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi subjektin politik AAK, më datë 08.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më

datë 09.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik AAK, sipas afatit të caktuar.

### **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;*

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i vlerëson se subjekti politik AAK shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi andaj konsiderohet si recivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjobë. Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim te nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 344/2010 më datën 10.12.2010

Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala

